

MANOLA MYRTA

VEÇORI MORFOLOGJIKE TË ELBASANISHTES

Hyrje

E folmja e Elbasanit i përket dialektit të gegërishtes. Ajo klasifikohet në gegërishten jugore dhe në grupin e të folmeve të Shqipërisë së Mesme. Kjo e folme karakterizohet nga një sërë tiparesh të përbashkëta për të gjitha të folmet e tjera të gegërishtes, por gëzon, njëkohësisht, edhe disa tipare karakteristike të saj. Po si paraqitet aspekti morfologjik i të folmes së Elbasanit gjatë përdorimit të përditshëm? A shfaqen tiparet e saj në të njëjtën mënyrë tek folës të grupmoshave të ndryshme?

Gjatë një studimi që i kemi bërë elbasanishtes kemi vënë re që, përveç të tjerash, disa trajta fjalësh kanë mbetur si pjesë e leksikut të grupmoshave relativisht të mesme dhe mbimesatare, ndërkohë që tek brezat e rinj është përqaftuar trajta standarde.

Më poshtë do të paraqesim në mënyrë më të detajuar disa dukuri të veçanta të cilat paraqesin interes lidhur me këtë të folme.

1. Emri

1.1 Shumësi i emrave

a) Disa emra mashkullorë në trajtën e shumësit dalin pa mbaresë: *shok, zengjin, shkall, pllam (pëllëmbë), tumall (dhëmballë), zamak, shkollar, doktor, qërshan, pjes* etj.

b) E pranishme në këtë të folme, "sikurse në të folmet e Veriut"¹ është dukuria e formimit të shumësit me **-a**, për disa emra mashkullorë: *demela, fllanxa, dardaleca, erna, leshna*.

c) Formimi i shumësit me mbaresa **-na**: *bojna, barna, emna, mishna, byrekna, femna, erna*.

d) Formimi i shumësit duke marrë **-j**: *ullij, fqij, duhanxhij, kafexhij* dukuri e cila është e përhapur edhe "në të folmet e tjera të Veriut"².

1.2 Trajta e emrit

a) Emrat mashkullorë të cilët në të pashquarën mbarojnë me togun **ua**, trajtën e shquar e formojnë duke nxjerrë përsëri zanoren **o** në vend të diftongut dhe duke marrë mbaresën shquese **-i**: *ftua / ftu - ftoi, thua / thu - thoi*. Sipas J. Gjinarit kjo strukturë është tipike për të gjithë të folmet e Jugut dhe ato të Shqipërisë së Mesme, kurse në të folmet e gegërishtes veriore ata e formojnë

¹J. Gjinari, GJ. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë 2003, f. 215.

²Po aty.

duke nxjerrë zanoren **o** në vend të diftongut, duke marrë mbaresën shquese **-i**, por edhe duke nxjerrë bashkëtingëlloren **n** të temës së vjetër : *foni*.³ Kësaj kategorie i përket edhe trajta tjetër *thoni*, e fjalës thua / thu e pranishme në të folmen e Elbasanit krahas trajtës *thoi*, e cila vendos pika takimi midis dy kategorive të hetuara. Kuptohet që ky rast nuk duhet përgjithësuar, por as nuk duhet mohuar si i tillë dhe, madje, ende i pranishëm në këtë të folme.

b) Emrat mashkullorë që në trajtën e pashquar mbarojnë me zanoret hundore **â, ê, î, û** në trajtën e shquar, rasa emërore marrin nazalen **n**: hini, peni, huni, gjuni, ullini, syni.

- 1.3 Rasat

Për dukuritë të cilat lidhen me sistemin rasor, jemi përqendruar në paraqitjen e disa tipareve më tipike të cilat shfaqin më tepër interes kur flasim për këtë të folme. Jemi përqendruar, kryesisht, në rasat gjinore, kallëzore e rrjedhore

- **Rasa gjinore.** Gjatë të folurit të përditshëm, në togfjalëshat e ndërtuar nga dy emra, përkatësisht, një emër në rasën emërore, dhanore e kallëzore ose nga një emër prejmbiemëror i ndjekur nga një emër i rasës gjinore, vihet re mungesa e nyjës së kësaj rase përpara emrit përkatës: *funi shpis, ke veni zjarrit, ke dera hymjes së shpis zjarrit, motra dhandrit, e marumja fjalës, jaka jelekut, shpia e dhandrit, goca shpis, gazi botës, m'u ke buza shkallve, mjalti shpis, Ura Zaranikës, degës hurmës, i vogli nanës.*

Rasa kallëzore. Në të folmen e qytetit të Elbasanit, emrat të cilët në trajtën e pashquar mbarojnë me **u** (në sajë të monoftongimit të togut zanor ua), e formojnë rasën kallëzore "duke iu ngjitur mbaresa -n, por veç kësaj, midis temës së emrit dhe mbiemrit del zanorja-**i**"⁴: *synin, kushurinin, ullinin, trunin.*

Rasa vendore. Në të folurit e përditshëm, sidomos në subjekte të moshës së vjetër, vihet re prania e të ashtuquajturës rase vendore, për të cilën gjuhëtari J. Gjinari shprehet: "Kjo formë e përbërë nga tema e kallëzores dhe nga mbaresa t(ë) është bërë zakon të quhet trajtë e rasës vendore"⁵. Emrat e rasës vendore paraprihen gjithmonë nga parafjalët **në, mbi, nën, nëpër, përmbi, me dhe për.** Në shembujt e paraqitur e kemi hasur, kryesisht, të paraprirë nga parafjala **në** e cila shfaqet me rënien e zanores **ë**: *n'torbët, n'dërrasët, n'dhet, n' hit, n' konakt, n'krahit, n'xhept, n'qafët, n'derët, n'rrugët, n'drekët, n' vesht, n'filxhant, n'qafë.*

2. Mbiemri

E folmja e Elbasanit karakterizohet nga disa tipare karakteristike edhe në sistemin mbiemëror. Në këtë të folme, sikurse edhe në të folme të tjera të gegërishtes, përta i përket gjinisë, mbiemrat e ardhur nga pjesorja e foljes

³ Po aty, f. 214.

⁴ Po aty, f. 216.

⁵ Po aty, f. 216.

dallohen jo vetëm nga nyja e përparme, por edhe nga mbaresa: *i feju:m – e fejume, i lçu:m – e lçume, i kthy:m- e kthyme, i mlu:m – e mlume.*

Krahas kësaj kategorie mbiemrash, në këtë të folme, sidomos në brezin e vjetër, është e pranishme edhe forma e disa mbiemrave prejpjesorë të formuar me prapashtesën – **un**: *i dalun, i shkurtën, i mërztun, e ngritun, e kallaisun, e zgjebosun, e kputun, të ngrituna, të kallaisunna.*

Në këtë kategori mbiemrash dallimi në gjini bëhet nëpërmjet një treguesi të vetëm, nyjës së përparme: *i dalun – e dalun, i ngritun – e ngritun, i kallaisun – e kallaisun, i shkurtën – e shkurtën, i mërztun – e mërztun.* Kur këto mbiemra janë në numrin shumës, treguesi gjinor bëhet mbaresa –(u)na, e cila i shtohet mbiemrit në femërore shumës, kurse trajta e gjinisë mashkullore shumës është e njëjtë me trajtën e njëjësit. Këto trajta të shumësit paraprihen, natyrisht, nga nyja **të**: *të dalun – të daluna, të ngritun – të ngrituna, të kallaisun – të kallaisuna, të mërztun – të mërztuna, të ngritun – të ngrituna.*

Në gjendjen e saj të sotme, e folmja e Elbasanit i ka të pranishme të dyja këto trajta dialektore të cilat nuk janë të njëjta për nga vjetërsia e tyre: forma e mbiemrave prejpjesorë të formuar me prapashtesën – **na** konsiderohet më e vjetër në krahasim me kategorinë e të njëjtit lloj, të formuar me prapashtesën –(ë)m, - m. Ajo, siç e përmendëm, është e pranishme tek moshat mbi 60-70 vjeç, ndërkohë që kategoria e dytë është pjesë e leksikut të moshave më të reja. Në të njëjtin kontekst, një **subjekt** përdor formën *e kputun, e dalun*, ndërsa një tjetër subjekt, po i kësaj kategorie moshore, shfaq tendencën e përdorimit të formës *e kputme, e dalme*. Pra, të dyja format janë në përdorim të vazhdueshëm brenda kësaj kategorie.

– Një tjetër dukuri përbën edhe shfaqja e mbiemrave prejpjesorë pa mbaresë: *i internu, i punu, i zbukuru, i liru, e festu, e pikturu, e menu, e harru, e përjetu, t'mësu, t'kalu, t'ledhatu.*

– Në të folurën e përditshëm vihet re mosprania e nyjës së mbiemrit, kur ai i është pranëvënë një emri të shquar në rasën emërore, zakonisht, në numrin njëjës: *pamja jashtme, menja re, si gjaja shplame, mineri madh, peni kput, vdekja sigurt.*

3. Përemri

3.1 Përemri vetor. Përsa i përket formave të përemrave vetorë, duhet pohuar që veçanti paraqesin format e vetës së parë njëjës të përemrit: **un** dhe **una** “që asht aq e njoftun në Elbasan”⁶: *un i thash, un e nimova, un e marova, erdha una, fleta una, e hudhësh una, una e priç, i mlodha una, sun bzaja una, sun t'i flisje una.*

Një shtrirje të gjerë në këtë të folme gëzon përdorimi i formës **mu** (mua) në rasat dhanore e kallëzore: *m'u mush menja, ma dha mu, m'ka noth mu, ma*

⁶ M. Çeliku, *Mbi të folmen e Dumresë*, BUSHT 2, 1963, f. 210.

prune ti mu, mir t' mbahet mu, ma ka heth mu, m' u than syt mu, m' largun mu, ma the ti mu, m' msun mu, ma mlodhën keq mu, m' lynte mu, m' njoftën mu, s' ka pun për mu, edhe ti s' ke besim ke mu, m' njipte mu. Duhet përmendur se, gjatë komunikimit të përditshëm, në këtë të folme kemi rënie të zanores ë tek trajtat e shkurtra të përemrit vetor të vetës së parë e të dytë në rasat dhanore e kallëzore: *m' dukesh, m' vun, m' sun, m' çonte, m' gjen, m' njipte, m' thu, m' shif, m' lun, m' prun, m' vjen, m' lishin, do m' takoshin, t' ka shpëtu, t' ban, t' nejtë, t' pritshin, t' kam ba, t' haet, t' japim, t' shof, s' t' lun, t' djek, t' nimoftë, t' bi, t' nifsha, t' nejtë, t' nrite (të ndriste), t' nectë.*

3.2 Përemri dëftor. Përemrat dëftorë janë të karakterizuar nga disa veçori të cilat lidhen me përemrat **ky, kjo, ai, ajo, ata**. Përemri dëftor **kjo** shfaqet në formën **qo**, kryesisht, në moshat mbi 50 vjeç: *quhet qo, qo e cipmja, ni qo ishte ma para, ktu te qo, qo ishte pjesa e jashtme, ene qo ash, qo qi erth, qo që t' thash, qo e reja, qo e mlumja, qo e martumja, qo e ndamja, qo menjemadhja, qo e hummja, ene qo e funit fare.*

Përemri dëftor **ky** në rasën kallëzore, numri njëjës, del në format: **kët, kte**: *kët çun, këtë njeri, këtë t' qeshme, kte mirni, kte e kam ngju, ma tregun kte .*

Përemrat dëftorë **ky, kjo** në rasën kallëzore shfaqen në format **kta** dhe **kto**: *kta t' ri, kta kishin shku, kto t' raja, kto dit e funit.* Përemri dëftor **ai** në rasën kallëzore del në format **ate, atën / aten**: *pata shku me ate, ate e nimova, msova ate, i thash për atën, i dhash atën, atën qi m' the, atën qi kemi lan, du t' mar atën, aten ma mur, dul me aten, aten t' voglë, m' mallkun me aten, me aten ja dola.* Në rasën dhanore dhe rrjedhore ky përemër takohet në formën **atit**: *ja dhash atit, atit cunit, atit t' shpis, atit t' hujit, prej atit.*

Përemri dëftor **ata** në rasën dhanore e rrjedhore shfaqet në formën **atyne**: *atyne i pat than, ju qash*

atyne, nana i thot atyne, i pat qenis atyne, i patëm çu atyne.

Ruhet forma e vjetër e rrjedhore njëjës **asoj, ksoj** dhe e shumës **kësi** e cila haset edhe në formën **ksi**: *asoj djali, asoj nuse, asoj t' qeshme, asoj gazi, ksoj gjanash, ksoj fatkeqsish, ksoj traditash, kësi gëzimesh, kësi njerzisi, kësi rastesh, ksi miqsh, ksi t' knumesh.*

Trajtja **asoj, ksoj** paraqiten me një shtrirje më të gjerë krahasuar me trajtën **kësi, ksi**. Praninë e tyre mund ta vërejmë si në leksikun e moshave të vjetra, ashtu edhe të moshave mesatare. Ndër to, trajta **kësi** (ksi), na rezulton si më e vjetër dhe me një shtrirje më të kufizuar. Këtë gjë e mbështet fakti që kjo trajtë është pjesë e leksikut të subjekteve që i përkasin moshës së vjetër.

3.3 Përemri pronor. Dukuritë tipike të kësaj të folmeje lidhur me këtë kategori përemrash i referohen disa formave të veçanta të përemrave të vetës së parë dhe të dytë njëjës, të të dyja gjinive . **Përemrat??? im /ime** në të folmen e Elbasanit dalin në format **tem/teme**: *çuni tem, menimin tem, emni tem, babës tem, qytetin tem, trunin tem, i vogli tem, i bukri tem, i vujtmi tem,*

motra teme, shpia teme, menja teme, nana teme, e vogla teme, e vujtmja teme, e mira teme.

Përemrat **yt/jote** dalin me një shtrirje të gjerë në formën **tat/jot, tate:** *baba tat, guximi tat, menimi tat, vllai jot, kushurini jot, motra tate, shpia tate, e ardhmja tate, mirnia tate, amëlsia tate, bukuria tate, menja tate, e mira tate, dhimshunia tate.*

Përemri i gjinisë femërore **e tua** në këtë të folme del rëndom në formën **tuja:** *menimet tuja, shoqet tuja, t'qamet tuja.*

3.4 Përemri pyetës. E folmja e Elbasanit karakterizohet nga disa forma të veçanta të disave prej përemrave pyetës. Kështu:

Në rasën kallëzore është e pranishme forma **çin** për përemrat pyetës **cili, cila:** *me çin flet, s'di çin t'mash e çin t'lash, çin të dish, me çin sy, çin daç keq, çin di ma mir, çin të dush, çin t'marrish.*

Përemri **çfarë** del në format **çer, çar, ça, çe:** *çer s'ma kjo tokë, çer ban, çar lulje, çar yrneku, çar shef, ça modeli do vije, ça po flet, ça a kikli, ça ishte sergjëni, ça t'ishte, merrni buk me çe ta keni, çe t'i bash.*

Gjatë studimit, bazuar në tërësinë e materialit faktik të përdorur, na ka rezultuar se format **çer** dhe **çe** janë më të vjetra se format **çar** dhe **ça**. Vjetërsinë e tyre e provon përdorimi brenda një rrethi mjaft të kufizuar që përfshin vetëm tek moshat e vjetra, kurse format e tjera kanë një përhapje më të gjerë, madje, prania e tyre vihet re dukshëm dhe tek moshat e reja.

Në vend të përemrit pyetës **si** përdoret, me një shtrirje të konsiderueshme në të gjitha grupmoshat, forma **qysh:** *qysh ishte perdja, qysh i kam qep, qysh ta lexonin, qysh t'thush, qysh ta baj, si thosha dot qysh, qysh je, qysh ash, qysh e pe, qysh e bane, nuk m'tha qysh, qysh ja punove, qysh ja hudhe, qysh s'tu tha goja.*

3.5 Përemri i pacaktuar. Në këtë të folme bie në sy përemri i pacaktuar **ndonjë** i cili shfaqet në format **nei, noi, nai, nenji:** *nei goc, nei gja, nei llaf tjetër, noi nuse, noi tjetër, noi i huj, noi çun, nai dhit (dhjetë) lekshe, nai fmi, nai akullore, nai shëtitje, nai menje, nai goc, nai fjal, nai qen, nai i joti, nai i harrum, nai i njoft, nai moll, nai amëlcin, nei i huj, nei i ship, nei çun, nei ven, nai menje, nanji i lagjes, nanji qi s'e njef, nanji qi të do t' keqen, nanji barktham, nanji burr, blem nanji, foli nanji, t'i qisim nanji, nenji i huj, nenji t'lame, nenji t'huthme.*

Ndër to, për një vjetërsi relativisht më të madhe dëshmon forma **nei** e cila është e pranishme në të folurit e moshave të vjetra. Në të njëjtat kushte gjendet edhe forma **nenji**. Format e tjera janë, relativisht, më të reja, gjë e cila lidhet me vetë praninë e tyre në leksikon e moshave më të reja.

4. Folja

4.1 Mënyra dëftore

E tashmja: Në përgjithësi, në të folmen e Elbasanit ruhen mbaresat e trajtat e foljeve të zgjedhimeve të ndryshme, megjithatë, janë vënë re disa dukuri të veçanta të cilat kanë lidhje me këto aspekte:

Folja **jam** në vetën e tretë njëjës shfaqet me këto forma: **â, âsh, âsht:** kush â, gjuha jon â shqipja, ç'â ky çun, ç' âsh moj nan, âsht si fije, âsh ma tepër festa bektashjanve, âsh model lisho, âsh ar, kjo âsh takami, âsht goca mir, në qoft se âsht kismet, n' qoft se nuk âsht risme.

Foljet e tipit **ha, pi, rri, fle** përgjithësisht dalin pa mbaresë në vetën e parë të njëjësit, ndërsa në vetën e dytë e të tretë marrin mbaresën **-n:** *han, pin, rrin, flen*. Folje të tilla në tri vetat e shumës dalin me mbaresë të njëjta si ato të foljeve: *mësoj, këndo:* *hajm, hani, hajn, flejm, pijn, rrijn*.

E pakryera: Në të folmen e qytetit të Elbasanit, përgjithësisht, në numrin shumës në vend të mbaresave **-nim, -nit, -nin** dalin mbaresat **shim, -shit, -shin:** *veshim, harroshim, bashim, lushit, hashit, afroshin, blishin, dëfteshin, dilshin*.

Në vetën e parë njëjës, sidomos në brezin e vjetër, folja merr mbaresën **-je:** *e lexoje, e shifje, e knoje, e menoje, e qetsoja, e mloje* (e mbuloja), *e shifja, e quja, e shkruaje* (e shkruaja).

Veta e tretë njëjës, sidomos në brezin e vjetër, ndërtohet me rënien e tingullit **n** të mbaresës **-nte**, duke u dhënë foljeve këtë formë: *bate* (bënte), *i bite, dëftete, ledhatote, mate* (mbante), *qate, shkëlqete, rrite, vite, zite*.

E kryera e thjeshtë: Foljet të cilat mbarojnë me zanore e formojnë vetën e tretë njëjës me një **v** antihiatizuese ndërmjet temës dhe mbaresës:⁷ *qavi* (qau), *shavi* (shau), *lavi* (lau), *pivi* (piu), *fillovi* (filloi), *largovi* (largoi). Për këtë dukuri “dalohen të folmet e zonave të Korçës, të Pogradecit dhe të Kolonjës.”⁸

- Bie në sy ndërtimi i tri vetave të shumës me mungesën e zanores **a** të togut **ua** në të dyja diatezat: *dashurun, gatun, takun, shkum, konsultum, fillun, gatun, takun, u interesum, u kujtum*.

Kjo dukuri është e pranishme edhe në mënyrën lidhore e urdhërore: *t'i thush, ta qush, ta dush, të rush; thuje, duje, quje, luje, shuje, ruje*.

Disa kategori foljesh dalin pa mbaresë në vetën e tretë njëjës si:

- folje të cilat dalin me **-t⁹:** *net, flet, mëshitet, met, përshnet*.

- folje me temë në bashkëtingëllore, kryesisht foljet me **-ol(l), -or** (r): *mur, dul* etj. Këtë trajtë këto folje e ruajnë edhe në numrin shumës: *murën, dulën*.

⁷ J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 229.

⁸ Po aty.

⁹ M. Çeliku, *E folmja kalimtare e Shpatit*, “Dialektologjia shqiptare”, I, 1971, f. 228.

Duhet thënë që kjo formë e këtyre foljeve nuk është e përhapur në këtë të folme. Ajo nuk dëgjohet në asnjë kategori moshore, përveç folësve që i përkasin brezit mbi 70 vjeç. Ky fakt na bën që ta konsiderojmë atë si një dukuri gjuhësore në bjerrje të vazhdueshme, deri në mospraninë e saj në këtë të folme në një bë ardhme jo të largët.

E ardhmja: Në të folmen e Elbaskanit veçoritë që karakterizojnë këtë kohë të foljes janë të lidhura me pjesëzën **të** dhe **do**:

Në të folurit e përditshëm, pothuaj, takohet vetëm forma me rënie të zanores **ë**, madje edhe me rënien të pjesëzës **të**: *do t'bi, do t'hyj, do t'ikësh, do dal, t'loth, do shkeli, do hidheshin*

Tipike, sidomos te moshat e vjetra, është formimi i së ardhmes me pjesëzën **da**: *do e mloje, da e maroje, da e shkruje, da e filloje*.

Forma pësore - Në të folurit e përditshëm mbaresat e kohës së tashme dalin pa bashkëtingëlloren **h**, duke marrë të njëjtat mbaresa si kategoria e foljeve të cilat mbarojnë me bashkëtingëllore: **-em, -esh, -et, -emi, -eni, -en**: *baem, bashesh, baet, baemi, baeni, baen*.

Tek e pakryera e dëftores bie në sy mbaresa **-(h)esh** në vetën e tretë njëjës: *lahesh* (lahej), *knohesh* (knohej), *qeshesh* (qeshej), *rriheshin* (rrihej).

Tek e kryera e thjeshtë, në këtë të folme, vërehet, sidomos në brezin e vjetër, aoristi sigmatik, sikurse në të folmen e Shpatit¹⁰ dhe të Shqipërisë së Mesme¹¹: *u gzu :sh, u hu:dhësh, u qu:sh (u zgjova), u smu:nësh, u lo:dhësh, u qetsu:sh*.

4.2 Mënyra lidhore Në të folmen e Elbaskanit bie në sy mbizotërimi i të tashmes së lidhore me rënie të zanores në pjesëzën **të**: *t'bi, t'hyj, t'haesh, si t'thuash, t'ishe, t'dal, t'pritshin, t'loth, t'shkeli, t'hidheshin*.

Kjo pjesëz nuk dëgjohet zakonisht:

a) kur lidhore i prin folja **mund**¹² e cila në grupmoshat mbi 50 vjeç haset në formën *sun : sun i thuash, sun e ngjosh, sun e takosh, sun e shofish*.

b) kur lidhoren e prin pjesëza e mohimit **mos**¹³: *mos rrish, mos flesh, mos knaqesh, mos e qas, mos e lush*.

c) kur fjala pasuese fillon me bashkëtingëllore **t** ose **d**¹⁴: *çin takosh, çin dush*.

Këto tipare të rënies së pjesëzës **të** të lidhore, siç vë në dukje M. Çeliku, e paraqesin të folmen e Elbaskanit, në disa raste, me disa ngjashmëri me të folmen kalimtare të Shpatit.

¹⁰ Po aty, f. 232.

¹¹ J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 240.

¹² M. Çeliku, *E folmja kalimtare e shpatit*, "Dialektologjia shqiptare", I, 1971, f. 233.

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty.

Në këtë të folme vihet re që foljet të cilat mbarojnë me bashkëtingëllore e formojnë vetën e dytë e të tretë të së tashmes njëjës me mbaresat **-ish, -i**: *të mos humi, të përcjelli, të shofish, t' shkeli, t' fusish, t' vراسi (veten), t' kapi, ta përplasish, të puthish, të pëllcasish, t' i shtypish, ta varish*.

Tek ndonjë subjekt mbi moshën 80 vjeç, dëgjohe formimi i vetës së tretë të kohës së tashme të lidhore me mbaresën **-ç**, tipike për të folmet e toskërishtes: *t' veç, t' fuç etj.*

E pranishme në të folmen e Elbasanit është forma e vetës së tretë njëjës e kohës së tashme, pa mbaresë. “Kjo formë u përfitua nga rënia e mbaresës **-ë**, me të cilën këto folje e kanë pasur formuar formën e vetës së tretë njëjës”¹⁵: *t' qe:sh, t' he:dh, t' fla:s, t' mle:dh*. Zanorja e theksuar e tyre, siç vëren Mehmet Çeliku, është e gjatë.¹⁶

4.3 Mënyra urdhërore. Mosprania e dukurisë së rotacizmit, e cila gjen një shtrirje mjaft të gjerë në këtë të folme, shtrihet në disa folje të tipit **bëj, vë, lë, zë** të cilat dalin me bashkëtingëlloren **n**: *bane-bani, vin-vini, lin- lini, zin-zini*.

Trajta e pësore e vetës së dytë shumë e mënyrës urdhërore formohet nga tema e foljes dhe mbarosa **-i**: *prishi, lodhi, qeshi* (qeshuni), tipar i cili e afron këtë të folme me të folmen e Shpatit.

Foljet që mbarojnë me zanore e formojnë urdhëroren duke marrë tingullin antihiatizues **h**: *nrihi* (ngrihuni), *lahi* (lahuni), *qahi* (qahuni), *bahi* (bahuni), *vih* (vihuni). Dukuritë e sipërpërmendura takohen, sidomos, në të folurit të brezit të vjetër.

Kjo diatezë formohet në të njëjtën mënyrë edhe atëherë kur folja prihet nga pjesëza **mos** (osa mo): *mo qeshi, mo lahi, mo bahi, mo vihi, mo mërzi*.

5. Format e pashtjelluara

5.1 Pjesorja. Në të folmen e Elbasanit, përgjithësisht, foljet e zgjedhimit të parë dalin pa mbaresë: *punu, msu, kënu, ba, la, mallku, mulu, maru, fitu, luftu, gatu, pranu, eduku*.

Disa folje të zgjedhimit të parë si edhe disa folje të parregullta e supletive, sikurse ndodh edhe në të folmen Shpatit, në pjesore marrin mbaresën **-n**: *lan, than, përzan, dhan, ran, van*.

Tek disa subjekte të vjetër takohet forma e pjesores me mbaresën **-m**, si në rastin e foljes bëj e cila del me formën *ba:m*, kurse në mbarë moshat e tjera del me formën tipike *ba*: ose *bërë*.

5.2 Paskajorja. Në këtë të folme përdoret gjerësisht paskajorja perifrastike e ndërtuar me pjesëzën parafjalore **për** dhe **emri prefoljor asnjane i pashquar** (për të punuar), sikurse edhe në të gjithë toskërishten dhe

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Po aty.

në të folmet e Shqipërisë së Mesme¹⁷: *për t'flejt, për t'pi, për t'gatu, për t'i majt, për t'net, për t'u pa, për t'qëllu, për t'friksu, për t'marr, për t'menu, për t'blu.*

Në të folurit e moshës mbi 50-60 vjeç, haset edhe paskajorja e formuar nga pjesëza përemërore **me** e cila “në gegërishten veriore dhe në shumë të folme të gegërishtes qendrore kjo është paskajorja dominuese. Ajo ka një përdorim të madh edhe në të folmet perëndimore të Shqipërisë së Mesme, kurse në anët e Elbasanit dhe në të folmet kalimtare është më pak e përdorshme¹⁸. Kjo dukuri shfaqet kryesisht tek moshat e vjetra, në përdorime të tilla si: *eth me fjet* (erdhi për të fjetur), *shkun me bamë* (për të bërë), *shkum me fol* (për të folur).

5.3 Përcjellorja Në të folmen e Elbasanit forma më e përhapur e përcjellores është ajo e ndërtuar me pjesëzën **duke**, por në subjekte mbi 60 vjeç takohen edhe përdorime në të cilat kjo pjesëz shfaqet në formën **tuke** dhe **tuj**; forma **tuke** është mbizotëruese dhe tipike sidomos për kategoritë mbi 70 vjeç: *tuke e la, tuke e ledhatu, tuke hec, tuke knu, tuke menu, tuke kalu, tuj menu, tuj kënu, tuj shetit, tuj pi.*

6. Ndajfolja

E folmja e Elbasanit karakterizohet nga disa forma të veçanta të ndajfoljeve të llojeve të ndryshme.

6.1 Ndajfoljet e kohës. Ndajfolja e kohës **tani** del në format **ime, nime, tashi, nashti**: *e maj men si ime, ime u kthy, hangu nime, fjetën ime, ime sa marun, ime do veç, nime sa erth, nime sa e zun, tashi tham, a von tashi, tashi sa u ulësh.*

Në vend të ndajfoljes së kohës **pastaj**, përdoren format **ani, eni**, mjaft të përhapura në këtë të folme: *do merrje ani, ani tjetra, prun kto ani, z'do e shifje me sy ani un, ani pritesh fjala, ani tjetra, i prun kto ani, ani ve buzët, ani ikët tuke kërcy, uleshin eni, eni do baheshin gati, eni u largu, fillum hallet e jetës eni, eni vishin fmit, e merrshin eni, fillonte eni, eni merrshin i gjilpan, mas dy –tre ditësh eni.*

Ndajfolja **atëherë** shfaqet në formën **mat'here**: *m'u mush mu mat'here menja, e dhash un mat'here fjalën, mat'here baheshin për paj shamija koke, i hoth daja mat' here, kan arth shumë gra mat'here, nuk i kam ba mat'here, kur fejohesh goca mat'here, i thon atyne mat'here.*

Në këtë folme shfaqen format **masanej, masanaj** (pas kësaj, pastaj): *masanej zgjatte dy jav masanej kto ishin t'pajës, masanej n' gezime, masanaj ma nuk të pashë, masanaj u harru.*

Ndajfolja **herët** shfaqet në formën **herjet**: *u nritsh herjet, dul herjet, erth herjet, kan flet herjet.*

¹⁷ J. Gjinari, Gj, Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 241.

¹⁸ Po aty.

Ndajfoljet **përsëri** del ne formën **poprap**: *u bana nuse poprap, m'gudit poprap, u kthy poprap, u pajtun poprap, e mur poprap, e doq poprap, e ktheu poprap.*

Në vend të ndajfoljes **fillimisht** shfaqet forma **sefte**: *e msova sefte, u pam sefte, ja thash sefte, u futësha sefte, e zun fill sefte, erth sefte.*

Ndajfoljet **ndonjëherë, asnjëherë** për shkak të shfaqjes së numërorit **një** në formën **i** përdoren rëndom në formën: **noiher, naiher, asier**: *kemi shku naiher, noiher edhe kam pas dal, nuk e kam menu noiher, nuk m'ka shku n'men naiher, asiher s'kisha vojt, nuk kam dal asiher, asiher s'kishte bzajt.*

6.2 Ndajfoljet e vendit. Gjen përdorim forma **përqark dhe qark e përqark** për ndajfoljet e vendit **përreth dhe rreth e rotull**: *vite tymi përqark, kurse përqark tjerët sipas rradhës, do vite përqark, baje badena përqark, jeleku përqark, rrite përqark, i shkote përqark, i bije përqark; i shkoje qark e përqark, e qenisje qark e përqark, e mloje qark e përqark, i millje qark e përqark, ja thojë qark e përqark, ja vije qark e përqark.*

Ndajfolja **poshtë** shfaqet në formën **rëposh**: *e vije rëposh, i çojë rëposh, rëposh krevatit, rëposh ktyne, rëposh shtresave, rëposh dyshekut.*

6.3 Ndajfoljet e mënyrës. Përdoren format **tjetërlløj, tjetërlløjna** për ndajfoljen e mënyrës **ndryshe**: *kto t'mijat jan tjetërsoj, ishin tjetërlløjna, kan pas qen tjetërlløjna, u vishshin tjetërlløj, jeta ka qen tjetërlløj, gjanat tjetërlløj, tjetërlløj t'hanën, tjetërlløj t'martën.*

Ndajfolja **kumplet** shfaqet edhe në formën **kumplet**: *do pritesh manga kumplet, kumplet gjanat, erdhën kumplet, i qita kumplet, ja dhash kumplet.*

Ndajfolja **njëlløj** shfaqet në formën **isoj**: *ishin isoj, isoj dy motrat, ja bleu isoj, i vishte isoj, i blite isoj, u dukshin isoj, maroshin isoj, e knoshin isoj.*

Shfaqet në këtë të folme forma **ksi farsoj** (kështu): *nuk duroj mo ksi farsoj, mos më fol ma ksi farsoj, ma punove ksi farsoj.*

Ndajfolja **fshehurazi** shfaqet rëndom në formën **mçeftas**: *hyn mçeftas, i pash mçeftas, u takuam mçeftas, i fol mçeftas, murëm mçeftas, e nxor mçeftas.*

6.4 Ndajfoljet e sasisë. Ndajfolja e sasisë **pak** shfaqet në formën **içik, içikëz**: *içik sheqer, içik oris, içik sherbet n'filxhant, i tresje me içik uji, me içik sungjer lyje fytyrën, me içik uj mrena, bashin içik trash, jan içik t'trishtume, içik sa për adet, ne me içik prush, ik içik ke oda madhe, içik të ranohesh, içik e gjat, içikëz gjevrecke, içkëz e hidhun, içikëz me huqe, içikëz me t'vjetrën, içnikëz e turpshme.*

Lidhur me përdorimet e sipërpërmendura duhet pohuar se: format **eni, mat'here, masanej, masanaj, sefte, qark e përqark, rëposh, tjetërlløjna, kumplet, ksifarsoj, içkëz** janë tipike, sidomos për brezin e vjetër, kurse në subjektet me moshë mesatare e të re, përgjithësisht, janë konsoliduar format standarde përkatëse.

7. Parafjala

Në vend të parafjalëve **te, tek** të rasës emërore gjen një shtrirje të konsiderueshme në të gjitha kategoritë moshore forma **ke**: *ke veni zjarrit, ke kpuçari, ked era, ke gruri, ke seqja ke furra, ke Ura Shkuminit, ke bishti syut, ke lumi, ke daja, ke furra, ke ky çun, ke e ama, ke e bija.*

Parafjala **nga** shfaqet në formën **na** sidomos në subjekte të moshës mbi 50 vjeç: *na ajo, na gzimi, na Gjinari anej, na Shpati, na ato fmit, na menja, na puna, na Librazhdi, na Elbasani, na rrjedha lumit, na turqishtja, na vitet, na buza krahit, na çitjanet.*

Parafjala e rasës rrjedhore **prej** në ndonjë subjekt të moshës së vjetër, mund të dëgjohej edhe në formën **pri** si në shembullin: *pri atyne.*

Në të folmen e Elbaskanit parafjala **në** e rasës kallëzore në subjekte të moshës mbi 50 vjeç takohet edhe në formën e vjetër **më** (me), tipike kjo edhe për të folmen e Shpatit: *me 'i arkë (në një arkë), m'dy faqet (në të dyja faqet, m'pes (në pesë), me 'i ven, me 'i shpi, me i krevat, me i mur.*

Në subjekte të moshës së mesme e, sidomos, të moshës së re është më e **paktë** tendenca e shfaqjes së kësaj forme me ndonjë përjashtim si: *ka dal me nai shoqe, ka shku me nai ven.*

8. Pjesëza

Gjatë përdorimit të përditshëm në të folmen e Elbaskanit është vënë re që: në vend të pjesëzës **ja** përdoret fjalëza **ni**: *ni kjo ishte, ni qo ishte ma para, ni kush ka qen, ni kjo ash takami, ni ime erth, ni sot e maroj, ni fmit ku jan, ni shpia tem, ni ku e ke, ni ke po vjen, ni çuni tat.*

Në vend të pjesëzës **le** përdoret fjalëza **ne**: *ne t'metet, ne t'futet, ne t'qeshi, ne t'ja japin.*

Konkluzione

Nga sa diskutuam më lart, duhet pohuar që e folmja e qytetit të Elbaskanit gëzon tërësinë e dukurive morfologjike karakteristike për të folmet e Shqipërisë së mesme. Midis tyre vumë re edhe disa tipare të cilat i përkasin substraktit gjuhësor të toskërishtes, të cilat ishin të përqendruara, kryesisht, në leksikon e brezit **mesatar e të vjetër**. Sidoqoftë, duhet pohuar që përhapja gjithnjë e më shumë e variantit standard dhe përballja e vazhdueshme në mënyra e forma nga më të ndryshmet me të, po krijon një farë shtresëzimi të këtyre tipareve: një pjesë e tyre kanë mbetur si fond leksikor i moshave të vjetra, ndërkohë që tek brezat e rinj po përqafohen në mënyrë progresive trajtat standarde.

BIBLIOGRAFI

Beci, B., *Rreth tipareve karakteristike të dy dialekteve të shqipes*, në "SF", 2, Tiranë, 1970.

Çeliku, M., *E folmja e Dumresë*, Buletin USHT 2, 1963.

Çeliku, M., *Mbi grupin e të folmeve të gegërishtes jugore dhe mbi disa tipare të tyre*, në SF 3, 1968.

- Çeliku, M., *E folmja kalimtare e Shpatit, Dialektologjia shqiptare* 1, 1971.
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e shkencave, Tiranë, 1973.
- Elbasani Enciklopedi*, Elbasan 2003.
- Gazeta “Albania”, viti IX, London, 1905.
- Gazeta “Dielli”, 1909.
- Gazeta “Lirija”, Selanik, 1909.
- Gosturani, Xh., *Dukuri fonetike në sistemin e zanoreve të së folmes së Elbasanit*, në SF, 2, 1985.
- Gosturani, Xh., *Sistemi i bashkëtingëlloreve në të folmen e qytetit të Elbasanit*, në SF, 1, 1983.
- Gosturani, Xh., *Disa ndërtime të togfjalëshit në të folmen e Elbasanit*, në SF, 2, 1987.
- Gosturani, Xh., *Disa ndërtime të periudhës në të folmen e Elbasanit*, në SF, 4, 1986.
- Gjinari, J., Marrëdhëniet e sotme të gjuhës letrare me dialektet, në SF,1, 1965.
- Gjinari, J., Shkurtaç, Gj., *Dialektologjia*, Tiranë, 2003.
- Haxhihyseni, Sh., Gur i randë n’vend të vet, Elbasan, 2004.
- Hylli i dritës*, nr. 4, Tiranë, 1993.
- Kostallari, A., *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa problem themelore të drejtshkrimit*, Tiranë, 1973.
- Myzyri, I., *Nji lule e bukur*, Tiranë, 2003.
- Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës*, Akademia e shkencave, Tiranë, 1973.
- Ortografia e gjuhës shqipe*, Instituti i shkencave, Tiranë, 1951.
- Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2003.
- Shkurtaç, Gj., *Etnografia e të folurit*, Tiranë, 2005.
- Hudson, R., Sociolinguistika, shtëpia botuese “Dituria”, 2002.
- Hymes, D., *Model of interaction of language ad social life*, në “Sociolinguistics”, Paulson, B.C., and Tucker, G.R., U.S.A., 2003.
- Spolsky, B., *Sociolinguistics*, U.S.A. 1998.
- Trudgill, P., *Sociolinguistics variations and change*, Great Britain, 2002.